



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2024:108429

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746666

P.nr.79/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses-praktikantes Qendresa Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.A nga fshati ..., Komuna Skenderaj për shkak të veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par.4 lidhur me par.2, të KPRK-së, si dhe *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 321 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.651/23 të datës 08.04.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, i datës 20.05.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit E.A, si dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës Zyrtare av.Shkelqesa Musa-Sejdiu, e dëmtuara Xh.Sh, me datë 21.05.2024 shpalli, ndërsa më datë 28.05.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: E.A nga i ati E, e ëma I, e vajzërisë Sh, i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna Skenderaj ka të kryer shkollën e mesme, i vetëpunësuar, i pa martuar, prind i një fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

I

SEPSE: Me date 04.05.2023, rreth orës 04:00, ne rrugën "...", saktësisht ne parkingun e banesës ku jeton e dëmtuara, i pandehuri me dashje seriozisht e ka kanosur te dëmtuarën Xh.Sh-viktme e ndjeshme, me fjalët se do ti shkaktoje lëndim te rende trupore, ne atë mënyrë qe pas një konflikti verbal e kap për rrobave dhe e shkund duke i thënë "kësaj here e ki qashtu, tjera here kom me ti thy kom e dur" dhe largohet nga aty, pastaj i shkruan motrës së të dëmtuarës, ku i thot " ja kom thy telefonin herën tjetër kom me ja thy kom e dur"

- Me këtë ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181par.4 lidhur me par.2, të KPRK-së.

II

Me date 04.05.2023, rreth orës 04:00, në rrugën ‘...’, ne Vushtrri, saktësisht ne parkingun e banesës ku jeton e dëmtuara, i pandehuri me dashje ka dëmtuar pasurinë e të dëmtuarës Xh.Sh, ne atë mënyrë që pas një konflikti verbal ja merr nga dora telefonin e markës ‘I phone X’ dhe ja gjuan për toke duke e thyer ne tërësi, me të cilin veprim të dëmtuarës i shkakton dem material rreth 300,00 €

Me këtë ka kryer veprën penale *Asgjësim apo dëmtimi i pasurisë* nga neni 321 par.1 të KPRK-së nga neni 182 par. 1, të KPRK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 dhe neni 181 par.4 lidhur me par.2, të KPRK-së dhe neni 321 par. 1 të KPRK-së si dhe neneve 364, 449, dhe 452 të KPPK-së:

## G J Y K O N

Të pandehurin E.A për veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.4 e lidhur me par.2 të KPRK-së i shqipton DËNIM MË BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, i cili do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 321 par.1 të KPRK-së i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej 300 (treqindë) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk do apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata këtë dënim do të ia shndërrojë në dënim me burgim, duke i llogaritur për një ditë burgim shumën prej nga 20 (njëzet) euro.

Pala e dëmtuar ka hequr dore nga kërkesa pasurore.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.651/23 të datës 08.04.2024, kundër të pandehurit E.A nga fshati ..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par.4 lidhur me par.2, të KPRK-së, si dhe veprës penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 20.05.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri

E.A dhe mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare av. Shkelqesa Musa-Sejdiu, si dhe e dëmtuara Xh.Sh.

*Deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë*

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, pas leximit të aktakuzës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin ose jo të fajësisë.

I pandehuri E.A pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e pranon në tersi fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur sepse atë natë kam qenë nën ndikim të alkoolit, madje kam pasur nervoze, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritet diçka e tillë, ka qenë hera e parë dhe e fundit, po ashtu ka shtuar se të dëmtuarës i ka kërkuar falje.

Pas pranimit të fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues edhe një herë e ka njoftuar të pandehurin me favorin dhe disfavorin e pranimit të fajësisë dhe me dispozitat e KPRK-së, por edhe pas kësaj i pandehuri ka deklaruar se dëshiron ta pranojë fajësinë në mënyrë vullnetare.

*Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i pandehuri është i vetëdijshëm dhe në mënyrë vullnetare e ka bërë pranimin e fajësisë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe me pranimin e fajësisë në tërësi vërtetohet përkrahimi i gjendjes faktike si në dy pikat e aktakuzës. Andaj nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, si dhe të obligoj të paguaj shpenzimet e procedurës penale, ndërsa gjatë matjes së dënimit për caktimin e lartësisë dhe llojit të tij të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ashtu që si rrethane lehtësuese të merre parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa si rrethane rënduese të merr parasysh faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, po ashtu gjatë matjes së dënimit ka propozuar që zyrtarisht të pajiset me evidence penale, që në rast se figuron se i njëjti është edhe me parë kryerës i veprave penale të merret si rrethanë rënduese dhe e kundërta si rrethane lehtësuese.

E dëmtuara ka deklaruar se ka dy muaj që është e qetë dhe nuk ka pasur ndonjë shqetësim prej të pandehurit pasi i njëjti ka krijuar familje tjetër, me ka kërkuar falje, por të nesërmen i ka përsëritur prapë te njëjtat veprime, nuk më intereson që i njëjti të më bejë ndonjë kompensim demi, por që i njëjti ishte dashtë që të jete me i kujdesshëm ndaj vajzës së përbashkëte. E gjitha çka kërkoj prej tij është që të mos ndërhyjë në jetën time.

Përfaqësuesja e të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se me qenë se i mbrojturi i sajë e ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohet, pas konsultimeve të mjaftueshme me të njëjtin ka konsideruar se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për efektin dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe ka konsideruar se pranimi i fajësisë është bërë në harmoni me dispozitën e nenit 241 të KPPRK-së andaj edhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal të merr parasysh një mori rrethanash lehtësuese të cilat ekzistojnë në anën e të njëjtit, e posaçërisht

pranimin e fajësisë, pastaj pendimin e shprehur, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe premtimin se nuk do të kryej vepra penale në të ardhmen, ashtu që nga të lartcekurat sa i përket të njëjtit janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 72 të KPRK-së, të njëjtit ti shqiptojë një dënim me kusht apo eventualisht dënim me gjobe, pasi ka konsideruar se këto sanksione penale të lartcekura janë adekuate me veprën penale të kryer nga i njëjti dhe rrethanat e arsyeshme ashtu që ka konsideruar se edhe me shqiptimin e ndonjërit nga këto sanksione penale tek i njëjti në tërësi do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal dhe rehabilitimi i të njëjtit.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurve.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit 2023-BD-326, i datës 05.05.2023; procesverbal i marrjes në pyetje për ankuesen Xh.Sh me numër të rasti 2023-BD-326, i datës 05.05.2023; procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin E.A me numër të rastit 2023-BD-326, i datës 10.04.2023; raporti i oficerit me numër të rastit 2023-BD-326, i datës 05.05.2023; raporti ditor i dhunës në familje i datës 05.05.2023; evidenca e të kaluarës kriminale; të dhënat për viktimat e dhunës në familje si dhe shkresat tjera të lëndës.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në deklarinimin e vetë të pandehurit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri E.A, me dashje ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.4 e lidhur me par .2 të KPRK-së, si dhe *Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë* nga neni 321 par. 1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 181 par. 2 të KPRK – së është parashikuar për veprën penale *Kanosja*, “*Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vite, ndërsa me par.4 si formë e kualifikuar është parashikuar se “*Kushdo që kryen vepër penale nga ky nen ndaj viktimës së ndjeshme ose me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndimi trupor ose dëmtimi i rëndë për shëndetin, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet*”, elemente këto të figurës së kësaj vepre penale që janë përmbushur tërësisht në këtë çështje penale, pasi që si nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjithashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri me dashje e ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.*

Në nenin 321 par. 1 të KPRK – së për veprën penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë, ka paraparë se “Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit”*, elemente këto të figurës së kësaj vepre penale që janë përmbushur tërësisht në këtë çështje penale, pasi që si nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjithashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri me dashje e ka kryer veprën penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 182 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje me të gjitha provat në shkresat e lëndës, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprat penale për të cilën akuzohet, ngase veprimet e tij përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale me të cilën ngarkohet dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se veprat penale për të cilën akuzohet i pandehuri, bazuar në nenin 181 par. 4 e lidhur me par.2 të KPRK-së, është e sanksionuar me dënim me burgim prej 1 (një) vit deri në 5 (pesë) vjet. Ndërsa bazuar në nenin 321 par. 1 të KPRK-së vepra penale si ne piken II te dispozitivit është sanksionuar me dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit.

Gjykata gjeti se ndaj te pandehurit mund te zbatohen edhe dispozitat për zbutje te dënimit si në nenin 70 par 3 pika 3.10, te KPRK-së kurse ne vështrim te dispozitave te nenit 71 par 1 te KPRK-së gjykata te pandehurit edhe i caktoi lartësinë e dënimit për veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par 4 te KPRK-së, kurse për veprën penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 182 par. 1 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar se është i mjaftueshëm edhe dënimi me gjobë si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për secilën nga veprat penale për te cilat i pandehuri është shpallur fajtor, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 70 dhe 71 të KPRK-së, sa i përket të pandehurit E.A ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur në gjykatë, premtimin se ne të ardhmen nuk do te kryej ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa sa iu përket rrethanave renduese gjykata mori parasysh por pa u kufizuar ne rrethanat se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallen e lart te dashjes në kryerjen e kësaj vepre penale (neni 70 par 2 pika 2.2 te KPRK-së), prezencën e dhunës dhe kanosjes me dhunë nga ana e te pandehurit (neni 70 par 2 pika 2.3 te KPRK-së) kurse rrethana tjera renduese nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se edhe me këto dënime, me burgim dhe me gjobë ndaj te pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandaloje personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjithashtu duke pasur parasysh të gjitha rrethanat tjera lehtësuese, dhe renduese gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë, dhe se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e kryerjes së

veprave penale, shkallën e përgjegjesisë penale të pandehurit dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

*Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës, dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 në lidhje me nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.79/24, datë 28.05.2024

Procesmbajtësja  
Qendresa Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.